



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME”
DIBËR

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 02.08.2023

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k, me të dhënat si më poshtë:

Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k

Shoqëria “4 A-M” sh.p.k me NIPT K92005016L me seli në Rruga Artan Lenja, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-re Tiranë.

Shoqëria “BONUS” sh.p.k me NIPT K72412009E, me seli në Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale 8330, Numri i Pasurisë 2/60-N11, Volumi 30, Faqe 105 1000.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur me mjete elektronike / Punë

Numri i referencës së proçedurës: **REF 72375-06-13-2023**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45000000-7 -- Punë ndërtimi

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Ndërtim i Linjës kryesore të Ujësjetës dhe Rrjetit Shpërndarës për fshatrat e Njesisë Administrative Xibër, Bashkia Klos.

Afati kohor për ekzekutimin: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Fondi limit: 187,872,714 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme: **Ka patur**

Numri i Referencës: Nr. REF 66194-04-14-2023

Procedurë e anuluar, pa ankim.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi, ju informojmë se në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k NIPT K01816001J

Vlera e Ofertës: 164,775,124.87 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS ” sh.p.k, me të dhënat si më poshtë:

Operatori Ekonomik Shoqëria “4 A-M” sh.p.k	NIPT K92005016L
Operatori Ekonomik Shoqëria “BONUS”sh.p.k	NIPT K72412009E

Vlera e Ofertës: 183,182,520 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

I. Oferta të refuzuara:

Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k me NIPT K01816001J, me vlerë të ofertës 164,775,124.87 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Për këto arsye:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga ky Operator Ekonomik, konstatoi se nuk plotëson kriteret si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k nuk përmbush kriteret e përcaktuara ne DST-në e publikuar nga autoriteti kontraktor duke qenë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar. Konstatohet se **Shtojca 1 “Formulari i Ofertes” dhe Shtojca 2 “Lista e çmimeve sipas zëerave të preventivit”** nuk janë ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Operatori ekonomik ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm **preventivin e punimeve**.
2. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor pasi nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik Shtojcën 8 “Formularin përmbledhës të vetedeklarimit” në kundërshtim me DST-në e publikuar nga autoriteti kontraktor dhe me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar, neni 26 i tij.
3. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7 te DST-së “Kriteret e vecanta” paragrafi **1 germa b**, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
4. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7 te DST-së “Kriteret e vecanta” paragrafi 2.3.2 **germa c**, pasi nuk disponon asnjë dokument të kërkuar nga autoriteti kontraktor në kërkesat si më poshtë:

”Në përputhje me kërkesat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

Materiale hidraulike dhe rakorderi ujësjellësi

- *Tuba dhe Rakorderi ujësjellësi PE 100 RC PN16*
- *Tuba dhe Rakorderi ujësjellësi PE 100 RC PN10*
- *Tuba dhe Rakorderi ujësjellësi PE 100 RC PN20*
- *Tuba dhe Rakorderi ujësjellësi PPR (polipropilen)*
- *Saracineska*

Operatori Ekonomik duhet te paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-

distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nenshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë te dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mesiperme te artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë qe janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Të gjitha materialet e mesiperme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane. Per Tubat PE 100 RC, Tubat PPR dhe saracineskat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjate procesit të vlerësimit të dokumentacionit”

Sa sipër, Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k nuk ka paraqitur Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit, Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve dhe vetëdeklarim për sistemin e menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve për listen e kërkuar të artikujve.

5. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY”sh.p.k nuk përmbush kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7 të DST-së “Kriteret e vecanta” **paragrafi 2.3.3 gërmat a,b,c,d,e,f,g**, ku është kërkuar të provojë kapacitetet e stafit kryesor e mbështetës si dhe punonjësit specialistë me çertifikimet përkatëse që duhet të disponojë ofertuesi për realizimin e punimeve objekt kontrate.
6. Operatori Ekonomik nuk përmbush kërkesat e parashikuara në paragrafin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit Shtojca 7 të DST-së, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” **ku është kërkuar:** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës. Përsa i përket kësaj kerkese, ky operator ekonomik nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik as Formularin përmbledhes të vetedeklarimit dhe **asnjë dokument tjetër që të provojë disponimin e makineri pajisjeve.**
7. Operatori Ekonomik nuk përmbush paragrafin 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ne Shtojcën 7 të DST-së, Kapitulli “Kapaciteti teknik dhe profesional” ku është kërkuar: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në perputhje me afatin kohor që është lenë në dispozicion për realizimin e kontratës. Nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik Shtojcën Nr 6 te DST-se, **grafikun e punimeve.**

Sa më lart, bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqërisë “DESARET COMPANY”sh.p.k.**

II. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k me NIPT K92005016L dhe NIPT K72412009E, me vlerë të ofertës: 164,775,124.87 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kualifikohet

Në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga Bashkimi Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS”sh.p.k, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, konkludon se ky Bashkim Operatorësh Ekonomikë plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimi /Kualifikimit.

Ky bashkim operatorësh ekonomikë dokumentacionin ligjor, administrativ dhe teknik e ka të rregullt **konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit.**

Gjithashtu plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në zbatim të Legjislacionit të Prokurimit Publik, VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor ka vendosur të pranojë ofertën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, **Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k, si dhe të kualifikojë si ofertë të vlefshme ofertën e paraqitur prej tij.**

Autoriteti Kontraktor në përfundim konkludoi:

Oferta të refuzuara:

1. Operatori Ekonomik Shoqëria “DESARET COMPANY” sh.p.k me vlerë të ofertës 164,775,124.87 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e katër pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Oferta të kualifikuara:

Oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k, me vlerë të ofruar prej 183,182,520 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Gjithashtu pas paraqitjes nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k, të **dokumentacionit provues** të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ky bashkim operatorësh ekonomikë rezultoi me dokumentacionin provues ligjor, administrativ dhe teknik të rregullt konform kërkesave të Dokumentave Standarte të Tenderit të publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, konkludohet se Oferta fituese është Oferta e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS” sh.p.k, me vlerë të ofruar 183,182,520 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë Shoqëria “4 A-M” sh.p.k & Shoqëria “BONUS”sh.p.k, me NIPT K92005016L dhe NIPT K72412009E, me adrese të selive perkatësisht Shoqëria “4 A-M” sh.p.k në Rruga Artan Lenja, Pallati i 4 A-M, Apartamenti A1, kati i I-re Tiranë dhe Shoqëria “BONUS” sh.p.k, adresa Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale 8330, Numri i Pasurise 2/60-N11, Volumi 30, Faqe 105 1000, se oferta e paraqitur me një vlerë totale 183,182,520 (njëqind e tetëdhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet) leke pa TVSH, / totali i pikëve të marra [_____]; është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër Sh.a, me zyra në adresën Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë, Shqipëri, **sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes / publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO

JO